

**RREGULLORE**

**E ORGANIZIMIT DHE FUNKIONIMIT**

**TE BRENDESTEM TE KESHILLIT BASHKIAK**

**BASHKIA FINIQ**

**VITI 2023**

# **I DISOZITA TE PERGJITHESHME**

## **Neni 1**

Këshilli I bashkisë Finiq organizon dhe kryen veprimtarinë e tij në përputhje të plotë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit Nr. 139/2015 datë 17/12/2015, "Për Vetëqeverisjen vendore" si dhe në përputhje të kësaj rregulloreje. Për çeshtje të cilat nuk parashikohen në këtë rregullore, këshilli merr vendime të veçanta.

## **II KONSTITUIMI I KESHILLIT**

### **Neni 2**

Konstituimi I Këshillit bashkiak kryhet në zbatim të ligjit 139/2015 datë 17/12/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore të Nenit 48 të këtij ligji si dhe udhëzimeve të Ministrisë së Brendëshme dhe prefektit të Qarkut.

## **III ORGANIZMAT E KESHILLIT**

### **A- KRYESIA E KESHILLIT**

#### **Neni 3**

Kryesia e këshillit bashkiak përbëhet nga kryetari dhe n/kryetarët.

Kryetari I këshillit dhe n/kryetarët e këshillit bashkiak zgjidhen nga rradhët e anëtarëve të këshillit bashkiak. Ata zgjidhen me votim të fshehtë.

Propozimin për shkarkimin e kryetarit apo të n/kryetarëve të këshillit bëhet të paktën nga 1/3 e numrit të anëtarëve të këshillit bashkiak.

Kryetari I këshillit kryen këto detyra:

- a) Thërret mbledhjen e këshillit në përputhje të nenit 48 të këtij ligji.
- b) Nënshkruan aktet që merr këshilli
- c) Përgatit rendin e ditës për mbledhjet të këshillit, vendin, datën dhe orë e caktuar të zhvillimit të mbledhjes me planin e miratuar si dhe duke tërhequr dhe mendimin e këshilltarëve dhe të kryetarit të bashkisë.
- d) Ndjek zbatimin e kësaj rregulloreje të këshillit.
- e) Ndiemon në kryerjen e rregullt të veprimtarisë së komisioneve të komisioneve të përherëshëm të këshillit.
- f) Bën të njohura këshilltarëve pr/vendimet, pr/urdhëresat si dhe propozime të tjera të ardhura në këshill.
- g) Siguron rregullin në sallën e mbledhjeve të këshillit.
- h) Verteton saktësinë e protokolleve të mbledhjeve të këshillit dhe kërkon që ato të firmosen nga sekretari I këshillit si dhe nga 1/3 e këshilltarëve.
- i) Përcakton bashkë me drejtuesit e grupeve të këshilltarëve vendet ku do të rinë këshilltarët gjatë mbledhjes si dhe të ftuarit si dhe vendin e kryetarit të bashkisë.
- j) Në mungesë të kryetarit të këshillit drejtimin e mbledhjes e bën njeri nga n/kryetarët.

## **B-SEKRETARI I KESHILLIT**

Sekretari I keshillit bashkiak emërohet dhe shkarkohet nga kryetari I keshillit mbi bazën e propozimit të kryetarit të keshillit, me shumicën e votave të numrit të përgjithëshëm të keshilltarëve. Shkarkimi I sekretarit bëhet dhe me propozimin e 1/3 të anëtarëve të keshillit.

Sekretari I keshillit kryen këto detyra:

- a) Mbajtjen e dokumentave zyrtare të keshillit.
- b) Ndjekjen e punës për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve të keshillit sipas rendit të ditës.
- c) Njoftimin për zhvillimin e mbledhjeve të keshillit.
- d) Shpalljen dhe publikimin e njoftimeve dhe akteve të nxjerra nga keshilli I bashkisë.
- e) Përgatitjen e seancave tëkeshillimit me bashkinë.
- f) Mbyqyrjen e respektimit të rregullores së organizimit dhe funksionimit të keshillit.
- g) Sekretari I keshillit kryen dhe çdo funksion tjetër që I caktohet nga keshilli.

### **Neni 4**

Marrëdhënjet e keshillit të bashkisë me organet e tjera mbrenda ose jashtë vendit , organizohen nga kryetari në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë këtë veprimtari. Përcaktimi I grupeve përfaqësuese në këto raste bëhet nga keshilli I bashkisë në mbledhje të rregulltë tij.

## **C-GRUPET E KESHILLTAREVE**

### **Neni 5**

Keshilltarët formojnë grupe keshilltarësh në përputhje me përkatësinë tyre politike ose orjentimin politik.

Numri më I vogël për formimin e një grupi është 3 (tre) keshilltarë.

Nuk mund të formohen grupe keshilltarësh në bazë të interesave lokale,etnike,fetare apo profesionale.

### **Neni 6**

Çdo grup paraqet te kryetari I keshillit vendimin për formimin e grupit ,listën e anëtarëve si dhe emrin e drejtuesit të grupit..

Kryetari I keshillit bënshpalljen e krijimit të grupit në mbledhjen e keshillit.

### **Neni 7**

Çdo keshilltarë mund të marrë pjesë vetëm në një grup keshilltarësh.

Keshilltari mund të largohet nga grupi pasi bën kërkesë me shkrim drejtuesit të grupit dhe kryetarit të keshillit.

### **Neni 8**

Grupi I keshilltarëve përcakton keshilltarët që do të diskutojnë në emër të tyre dhe rradhën e diskutimeve .



Ky rregull nuk kufizon të drejtën e këshilltarit të diskutojë individualisht sipas rradhës kur ai kërkon të diskutojë dhe për këtë ia ka kërkuar emrin kryetarit të këshillit.

## **D-KOMISIONET E KESHILLIT**

### **Neni 9**

Komisionet janë organe të këshillit .Ato kryejnë funksione për njohjene gjendjes dhe realizimin e iniciativës së kontrollit të këshillit . Komisionet e këshillit janë organe të përherëshme.

### **Neni 10**

Komisionet e përherëshme të këshillit janë;

1-Komisioni I mandateve dhe I rregullores.

2-Komisioni për çështjet e ekonomisë, financës dhe privatizimet.

3-Komisioni I zhvillimit urban,shërbimeve dhe strehimit.

4-Komisioni për arsimin,kulturën,turizmin dhe sportet.

5-Komisioni juridik,I rendit publik,mbrojtjes dhe emergjencave civile.

6-Komisioni për zhvillimet bujqësore, blegtorale dhe agrobiznesi.

7-Komisioni I barazisë gjinore .

8-Komisioni mbi mbykqyrjen ,kontrollin dhe nënshkrimin e proces verbaleve të mbledhjeve të këshillit.

Këshilli mund të bëjë ndryshime për veprimtarinë,numrin dhe përbërjen e komisioneve të përherëshme të këshillit.

### **Neni 11**

Numri dhe antarët e komisioneve zgjidhen nga antarët e këshillit me votim të hapur me propozim të kryetarit të këshillit, pas këshillimit paraprak me kryetarët e grupeve.

Anëtarësia dhe përbërja e komisioneve caktohet nga këshilli në përputhje me karakterin dhe veprimtarinë e komisioneve.

### **Neni 12**

Çdo këshilltar mund të zgjidhet anëtar deri në dy komisione të përherëshme të këshillit.

Një këshilltar mund të thirret dhe të kërkohet si ekspert në një komision ku nuk bën pjesë në të.

Kryetari dhe z/kryetarët e këshillit nuk mund të bëjnë pjesën komisionet e përherëshme.

Në komisione mund të përfshihen edhe specialist që nuk janë këshilltarë, por jo si antarë komisioni.

### **Neni 13**

Komisionet e përherëshme përgatitin pr/vendime ose pr/urdheresa dhe I paraqesin ato në këshill për shqyrtim apo miratim.

-3-

Komisionet e përherëshme diskutojnë pr/vendimet e përgatitura nga drejtoritë përkatëse të firmosura nga drejtoria juridike si dhe nga kryetari I bashkisë të shoqeruara me relacionin sqarues për çdo pr/vendim,propozojnë ndryshime nëse bëhen,diskutohen dhe I propozojnë këshillit bashkiak për vendim marrje në mbledhjen e rradhës.

Komisionet e përherëshme studjojnë dhe analizojnë efektivitetin e akteve në fuqi.(vendimeve,urdhëresave, rregulloreve etj.)

Komisionet e përherëshme shqyrtojnë raportet dhe relacionet e ndryshme që paraqet në këshillKryetari I bashkisë si dhe drejtoritë përkatëse.

### **Neni 14**

Nëpunësit e administratës së bashkisë si dhe ata të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore e private janë të detyruar t'u japin të gjitha të dhënat që u kërkohen nga komisionet në përputhje me aktet specifike.

### **Neni 15**

Komisionet e përherëshme të këshillit mblidhen nga kryetari I komisionit , me nismën e tij , me kërkesën e 1/3 të anëtarëve me urdhër të kryetarit të këshillit.

Këshilltarët marrin pjesë në komisione dhe kur nuk janë anëtarë ,por pa të drejtë vote.

Drejtoritë që kanë paraqitur pr/vendime në këshill marrin pjesë në mbledhjet e komisioneve në kohën e shqyrtimit të tyre duke caktuar përfaqësuesit e vet të cilët japin sqarimet e nevojshme mbi pr/vendimin përkatës.

Mbledhjet e komisioneve janë të vlefshme kur marrin pjesë më shumë se 1/2 e këshilltarëve.Vendimet merren si rregull me shumicën e votave të anëtarëve pjesëmarës në votim të hapur.

### **Neni 16**

Komisionet e përherëshme mund të organizojnë edhe mbledhje të përbashkëta dhe drejtohen nga një prej kryetarëve me mirëkuptim.

Në mbledhje të përbashkëta çdo komision merr në mënyrë të veçantë vendime për çeshtje të shqyrtuara.

### **Neni 17**

Për çdo projekt, akt të veçantë që shqyrton komisioni bën raportin e vet e ia paraqet këshillit në kohën e shqyrtimit të aktit. Raportimi para këshillit bëhet nga një anëtar I komisionit me propozim të drejtuesit të tij.Në raport pasqyrohen të gjitha qendrimet e mbajtura për çeshtjen e dhënë dhe shumica e votuesve me të cilin është marr vendimi I komisionit.

-4-



### **Neni 18**

Në mbledhjet e komisioneve mbahet protokoll i cili nënshkruhet nga kryetari I komisionit.

### **Neni 19**

Komisionet e përkohëshme formohen për një problem konkret për studimin apo përgatitjen e një pr/vendimi të caktuar.

Mënyrat e krijimit dhe e funksionimit të këtyre komisioneve janë të njëjtoja me ato të komisioneve të përhershme.

## **IV-MBLEDHJET E KESHILLIT TE BASHKISE**

### **Neni 20**

Këshilli I bashkisë thirret në mbledhjen e tij:

- 1-Me inisiativën e kryetarit të këshillit
- 2-Me kërkesën e kryetarit të bashkisë
- 3-Me kërkesën e 1/3 të anëtarëve të këshillit.

Thirrja e mbledhjeve të këshillit bëhet me njoftim me shkrim dhe shënohet në aktet e mbledhjes. Në njoftim shënohet rendi i ditës, dita, data, ora dhe vendi i zhvillimit të mbledhjes. Rendi i ditës u njoftohet këshilltarëve 5 ditë përpara zhvillimit të mbledhjes.

### **Neni 21**

Mbledhjet e këshillit janë të hapura për publikun. Vetë këshilli vendos me shumicë votash për mbledhje të veçanta të tij t'i bëjë të mbyllura. Problemet e buxhetit diskutohen kurdoherë në mbledhje publike. Propozimi për mbledhje të mbyllura mund të bëhet nga kryetari i këshillit si dhe nga çdo këshilltar duke përcaktuar problemin dhe arsyetimin për këtë propozim.

Persona të jashtëm në kohën e mbledhjes qendrojnë në vende të caktuara dhe nuk kanë të drejtë të shkelin rregullat e mbledhjes për çfarëdo lloj arsye.

Kryetari I këshillit vendos rregull e qetësi dhe mund të urdhëroj persona të veçantë që pengojnë mbarëvajtjen e mbledhjes të dalin jashtë nga salla e mbledhjeve.

### **Neni 22**

Kryetari I këshillit hap mbledhjen kur ëtë siguruar pjesëmarrja e më shumë se gjysma e këshilltarëve.

Kryetari anulon zhvillimin e mbledhjes kur vëren se nuk sigurohet shumica e këshilltarëve të nevojshëm për vazhdimin e punimeve.

### **Neni 23**

Kryetari I Këshillit për çdo mbledhje njofton këshilltarët për aktet e reja që I janë paraqitur ,si dhe eaporton për shprehjen e ligjëshmërisë për vendimet e një mbledhje të mëparshme.

Në fund të mbledhjes kryetari shpall datën e mbledhjes së ardhshme dhe projektin e rendit të ditës.

Propozimet për të shtuar problem për shqyrtim në mbledhjen e këshillit ,si rregullmund të paraqiten pas shpërndarjes së së thirrjes së mbledhjes ,por si përjashtim këshilltarët mund të propozojnë për t'u përfshirë në rendin e ditës problem të motivuara dhe ditën e mbledhjes.Këto propozime votohen në fillim të mbledhjes. Këshilli shqyrton vetëm probleme që janë në rendin e ditës së mbledhjes.

#### ***Neni 24***

Kryetari I këshillit drejton mbledhjen dhe u jep fjalën diskutuesve.Asnjë këshilltar nuk mund të diskutojëpa iu dhënë fjala.Fjala kërkohet me ngritjen e dorës nga vendi ose me shkrim paraprakisht.

Kryetari harton listën me emrat e këshilltarëve që kanë bërë kërkesë për të diskutuar dhe përcakton rradhëe diskutimeve në përputhje me kohën e bërjes së kërkesës.

#### ***Neni 25***

Për çeshtje produceriale fjala jipet menjëherë.Çeshtjet proceduriale janë ato që kanë të bëjnë me propozime për ndryshime apo në rregullimin e zhvillimit të mbledhjes.

#### ***Neni 26***

Këshilltarët flasin nga vendi.Nëse diskutanti shmanget nga tema, kryetari e paralajmëron dhe nëse shkelja vazhdon atij I hiqet e drejta e fjalës për atë çeshtje të rendit të ditës.Këshilltari nuk mund të diskutojë më shumë se një here në përmbajtje për çeshtjen që diskutohet.

Në rast kur këshilli vendos për kohën e kohëzgjatjes së diskutimit dhe diskutanti tejkalon kohën e përcaktuar ,paralajmërohet për të përfunduar dhe në rast se vazhdon atij I hiqet e drejta e fjalës.

#### ***Neni 27***

Këshilltari ka të drejtën e replikës.Replika është njëqendrim I paraqitur në mënyrë të shkurtuar për përmbajtjen e një diskutimi.Replika bëhet menjëherëpas diskutimit dhe nuk mund të vazhdojë më shumë se një minute.Për të njejtin diskutim mund të bëhen deri në dy replica.Pas replikës së bërë,këshilltari që ka diskutuar ka të drejtën e prgjigjes në një afat kohor deri në 2 minuta.

#### ***Neni 28***

Kryetari I këshillit ose n/kryetari mund të marrin fjalënsa here që e kërkojnë,por vetëm njëri prej tyre për çeshtjen që diskutohet.Të njejtën të drejtë kanë edhe drejtuesit e e grupeve apo këshilltarët e caktuar në emër të grupit të këshilltarëve.

Sekretari I këshillit merrpjesë në debat për argument ligjore.

#### ***Neni 29***

Në se lista emërore e këshilltarëve që kanë kërkuar fjalën ka mbaruar dhe asnjë këshilltar nuk kërkon fjalën atëhere kryetari I këshillit shpall mbylljen e debatit.Në rast se ka ,propozimi për mbylljen e debatit hidhet në votim përpara propozimit për shtyrje n e debatit.

Në rast se pranohet propozimi për mbylljen e debatit ,por ka kryetar grupi që nuk diskutuan në debat ,fjala I jipet njerit prej këshilltarëve për çdo grup.

#### ***Neni 30***



Në se në mbledhjen e këshillit krijohet zhurmë ose prishje të rregullit dhe cëohet ecuria e punës së tij, kryetari mund të ndërpres zhvillimin e mbledjes për 30 minuta dhe vet 0235 një here.

Mbledhja mund të shtyhet me vendim të këshillit dhe me propozim të kryetarëve të grupeve të këshilltarëve.

### **Neni 31**

Në mbledhjet e këshillit mbahet protokoli I mbledhjes nga një këshilltar I caktuar nga këshilli me votim, ose nga sekretari I këshillit bashkiak. Nuk lejohet që protokoli të mbahet nga kryetari apo n/kryetarët e këshillit. Në fund të protokollit firmoset nga kryetari, sekretari dhe së paku së paku nga pesë këshilltar.

### **Neni 32**

Të gjitha aktet që miraton këshilli nënshkruhen brenda 5 (pesë) ditëve nga data e miratimit të tyre. Në rastet kur janë bërë gabime në hedhjen e akteve të këshillit, korrigjimi i tyre bëhet me urdhër të kryetarit të këshillit pasi dëgjohet paraprakisht titullari që ka paraqitur aktin dhe referuesi nga komisioni përkatës I këshillit.

### **Neni 33**

Në rast se këshilltari mungon nga mbledhja e këshillit dy here rradhazi pa arsye, I tërhiqet vërrjte dhe me vendim të këshillit I pritët shprëblimi.

Në rast se këshilltari mungon 5 muaj rradhazi nga mbledhjet e këshillit pa arsye, me vendim të këshillit bashkiak I kërkohet subjektit politik të cilit ai I përket që të marr masa për të siguruar pjesëmarrjen e këshilltarit në mbledhje.

Kur këshilltari nuk merr pjesë në mbledhjet e këshillit 6 muaj rresht, mandate I këshilltarit quhet I përfunduar dhe me propozim të komisionit të mandateve dhe rregullorës, këshilli bashkiak e zëvendëson me këshilltarin rradhës të listës shumë emërore të subjektit përkatës.

## **V-VOTIMI**

### **Neni 34**

1-Votimi në këshill bëhet I hapur ose I fshehtë. Këshilli vendos se kur votimi bëhet I fshehtë.

Aktet me karakter individual merren gjithmonë me votim të fshehtë. Votimi I hapur kryhet I përgjithëshëm ose nominal. Votimi I fshehtë bëhet me fletë votimi.

2-Vendimet e këshillit merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

3-Vendimet merren me shumicën e votave të numrit të përgjithëshëm të anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në nenin 55, shkronjat "a", "b", "c", "d", "dh", "f", "g", "gj", "i", dhe "j" të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore".

4-Vendimet merren me 3/5 e anëtarëve të këshillit në rastet e parashikuara në nenin 54, shkronja "e" të ligjit 139/2015.

5-Në rastet e votimit për kryetarin, n/kryetarët dhe sekretarin e këshillit, nuk sigurohet shunica e kërkuar, votimi përsëritet midis dy kandidaturave që në raundin e pare kanë numrin më të madh të votave.

### **Neni 35**



Çdo këshilltar ka të drejtën e propozimit për mënyrën e votimit. Propozimi hidhet në votim pa debate. Kryetari shpall fillimin e procesit të votimit .Gjatë votimit nuk I jepet fjala asnjë këshilltari. Sipas nevojës,para votimit mund të tërhiqet grup I këshilltarëve që kërkon një pushim prej 5 minutash.

### **Neni 36**

Në rast kur kërkohet dhe vendos këshilli,votimi bëhet veças për çdo pike të pr/vendimit të paraqitur.Në këto raste hidhet në votë në fillim propozimi për heqjen fare të pikes (kur ka propozim të tillë) dhe pastaj votohet për ndryshimet dhe plotësimet e tij.

Në rast parregullsie në votim dhe me rezultat “pro”ose “kundër” votimi përsëritet.Në rastet kur nuk votohet “pro” me shumicën e votave ,propozimi nuk miratohet dhe hiqet nga vendimmarrja.

## **VI-PROCEDURA E PARAQITJES SE PR/VENDIMEVE NE KESHILL**

### **Neni 37**

Kryetari I bashkisë,komisionet e përherëshme ,këshilltarë të veçantë paraqesin në këshill pr/ vendime e projekt urdhëresa .Projektet së bashku me relacionet I paraqiten kryetarit të këshillit.

Pr/vendimet që kanë të bëjnë me çeshtje të administrimit të pasurisë së bashkisë ,me çeshtje financiare , duhet të jenë të shoqeruara me nënshkrimin e kryetarit të bashkisë.

### **Neni 38**

Kryetari I këshillit nëpërmjet sekretarit të këshillit ua shpërndan pr/vendimet si dhe gjithë dokumentacionin shoqërues komisioneve të përherëshme në përputhje me karakterin e përkatësinë e tyre.Komisionet e përherëshme në relacionet që paraqesin deklarohen për domosdoshmërinë e aktit ,dobinë e tij mundësinë financiare për plotësimin e tij.Ato bëjnë propozime të argumentuara para këshillit për ta pranuar projektin ashtu siç është,duke bërë ndryshime apo për të mos e pranuar.

Kur paraqitësi I projektit nuk është dakort me raportin e komisionit ,ai mund të paraqes në këshill një raport plotësues.

### **Neni 39**

Pr/vendimet dhe pr/urdhëresat shqyrtohen në këshill pas raportimit që bëjnë paraqitësit e tyre në komision.

Në rast se nuk paraqitet në këshill raport nga paraqitësi apo komisionet,duhet të bindet këshilli për domosdoshmërinë e aktit a projektit të paraqitur.

### **Neni 40**

Kur këshilli e sheh të arsyeshme merr vendim që projekti të rishqyrtohet pasi të plotësohet më tej.Në këtë rast këshilli cakton kohën e rishqyrtimit të tij.

**Neni 41**

Këshilltarët në mbledhjet e këshillit mund t'i drejtojnë pyetje kryetarit të bashkisë ose z/kryetarit . Pyetjet duhet të jenë të qarta ,të shkurtëra dhe të kërkojnë informata të domosdoshme për sqarimin e problemeve.Kur pyetjet për çeshtje të cilat kërkojnë përgatitje nga kryetari I bashkisë apo z/kryetari I duhet kohë,pyetjet drejtohen me shkrim një ditë përpara zhvillimit të mbledhjes së këshillit.

Këshilltari që pyet ka të drejtë të shprehet nëse përgjigjen nga kryetari I bashkisë e do me shkrim apo me gojë.Në rast se këshilltari që ka bërë pyetjen mungon ,kryetari I bashkisë apo zëvendësi i tij nuk i përgjigjet pyetjes duke e shtyrë për mbledhjen tjetër.

**Neni 42**

Kryetarit të bashkisë ose z/kryetarit i është bërë pyetja jep përgjigje me gojë ose me shkrim.Pas përfundimit të përgjigjeve ,këshilltari që ka bërë pyetjen ka të drejtë të bëj pyetje plotësuese për sqarimin e problemeve.

Gjatë përgjigjes së pyetjes nuk lejohet të bëhet debat.Pas përgjigjes së pyetjeve këshilltari ka të drejtën e replikës duke shprehur konsideratën e tij për përgjigjen e dhënë.

**Neni 43**

Kryetari I bashkisë mund të mos marr pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak.Në rast se këshilli e sheh të nevojshme pjesëmarrjen e kryetarit të bashkisë e fton atë të marr pjesë në mbledhje.

**Neni 44**

Rregullorja e Organizimit dhe Funkcionimit të këshillit bashkiak hyn në zbatim pas miratimit në mbledhjen e këshillit.

**KRYETARI I KESHILLIT**

**Thoma KALLOJERI**

